



Prishtinë, 28.03.2025
Kodi i ZRRE-së: V_2684_2025

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRrE/DMK_V_2633_01_25** i datës 16.01.2025;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës 11.02.2025.

në seancën e mbajtur më datë **28.03.2025** nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET** Kundërshtimi i KESCO-s, ndaj Vendimit të DMK-së për konsumatorin I.A., me shifër DGL – 9057713, si i pabazuar.
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2633_01_25 i datës 16.01.2025.
- III.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 16.01.2025 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK_V_2633_01_25 me të cilin e ka aprovuar si të bazuar në tërësi ankesën e konsumatorit I.A., lidhur me kontestimin e faturave, dhe e ka obliguar KESCO-n që konsumatorit me shifër DGL – 9057713, t'i anuloi faturat e muajit 12/2022 dhe 01/2023, dhe për këtë periudhë ta faturojë me shpenzimet e muajve 12/2023 dhe 01/2024 (pra shpenzimet e vitit të ardhshëm).

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, Furnizuesi KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRRE-së, për këto shkaqe:

- Shpenzimi i faturuar për periudhën kontestuese është i saktë, sepse konsumatori ka lexime të rregullta.
- Duke qenë se njehsori e ka bërë matjen e tërë shpenzimit dhe duke marrë parasysh që njehsori SMART i ka ruajtur të dhënat lidhur me shpenzimin mujor, shihet që shpenzimi brenda kësaj periudhe është regjistruar në njehsor dhe nuk ka asnjë dyshim të vetëm për lexim/faturim jo të rregullt apo jo të saktë.
- KESCO-ja kërkon nga Bordi i ZRrE-së pezullimin e Vendimit të DMK-së me nr. 2633_01_25 i dt. 16.01.2025.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2025 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest, si dhe vendin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Kundërshtimin e KESCO-s të datës 11.02.2025; Vendimin e DMK-së të datës 16.01.2025; Vendimin e KESCO-s të datës 29.03.2024; Ankesat e konsumatorit në KESCO dhe DMK; Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik me nr. 0046912 i dt. 31.01.2023; Procesverbalin e inspektimit me nr. 2142633 i dt. 11.03.2024; Transaksionet e konsumatorit, Rrjedhën e energjisë dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Kundërshtimi i KESCO-s **është i pabazuar**, sepse:

Në vështrim kronologjik të këtij rasti, Bordi ka gjetur se, me datë 27.01.2023 konsumatori ka parashtruar ankesë në KESCO – në Departamentin për Kujdes ndaj Konsumatorëve, duke i kontestuar në tërësi faturat e muajit 12/2022 dhe 01/2023, për shkak të dyshimeve për matje jo të saktë të njehsorit elektrik me nr. 20057257. Pas shqyrtimit të ankesës, KESCO-ja me datë 29.03.2024, ka nxjerrë Vendim, me të cilin e refuzon si të pabazuar ankesën e konsumatorit, dhe atë, duke u bazuar rrjedhë të energjisë, transaksione, lexime dhe procesverbalin me nr. 2142633 i dt. 11.03.2024, me arsyetimin se leximi dhe faturimi janë në rregull. I pakënaqur me këtë Vendim, konsumatori i është adresuar DMK-së, me datë 16.04.2024, duke i kontestuar në tërësi këto fatura, me pretendimet se, në këta dy muaj, ora e rrymës ka ecur kilovatët në mënyrë të pa kontrolluar, dhe pasi që i është ndërruar njehsori, gjithçka është normalizuar.

Nga analiza e përgjithshme që i është bërë Rrjedhës së Energjisë Elektrike, Listave të leximit dhe transaksioneve të konsumatorit, Bordi ka gjetur se, ky konsumator është i kyçur në rrjetin e energjisë elektrike që nga dt. 06.09.2022, për çka edhe konsumatori e kishte paguar taksën për shërbime në vlerë prej 118€. Më tej, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 28.12.2022 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën 12/2022 me **1547 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare **123.01 €** dhe me datë 27.01.2023 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën 01/2023 me **1692 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare prej **146.55 €**. Ndërkaq, pas kësaj periudhe kohore, vihet re që shpenzimet e konsumatorit janë më të ulëta. Duhet theksuar se, nga analizimi i Listave të Leximit, vihet re që konsumatori është lexuar dhe faturuar me rregull dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi në pikën matëse të konsumatorit.

Më tej, Bordi e shqyrtoi edhe Procesverbalin mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik, i dt. 31.01.2023, në të cilin punëtorët e autorizuar të KEDS ndër të tjera kanë evidentuar se, largohet nga matja njehsori elektrik me nr. 20057257 (njehsori kontestues), me gjendje të shpenzimeve prej TL = 13919 kWh dhe TU = 15351 kWh, ashtu që, për matje vendoset një njehsor i ri, me nr. 88768888 me gjendje të shpenzimeve prej TL dhe TU = 0000 kWh, ndërkaq në vërejtje të këtij procesi është evidentuar si vijon: *“Njehsori i ndërruar, dërgohet në Qendrën e Kalibrimit Prishtinë, për shqyrtim dhe verifikim”*. Pra, nga sa mund të shihet, Konsumatorit i ishte ndërruar njehsori, por që nuk është evidentuar arsyeja e ndërrimit të njehsorit. Lidhur me këtë çështje, Bordi thekson se, përkundër që



DMK ka kërkuar informacione nga KESCO për raportin e shqyrtimit të njehsorit nga QK për njehsorin e tërhequr, nga KESCO nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara.

Nëse i krahasojmë shpenzimet e konsumatorit, me muajt të njëjtë të viteve pasuese, vihet re se, shpenzimi i konsumatorit me njehsorin nr. 20057257 që nga periudha e regjistrimit e deri në periudhën kontestuese, është më i ulët, se sa faturimi i muajve dhjetor 2022 dhe janar 2023, ashtu që, shpenzimet e konsumatorit për periudhën para kontestit janë si vijon: periudha **09/2022** është **317 kWh**, periudha **10/2022** është **319 kWh**, periudha **11/2022** është **412 kWh**, ndërkaq, periudha kontestuese, pra periudha **12/2022** është **1547 kWh** dhe periudha **01/2023** është **1962 kWh**. Ndërkaq, shpenzime të ulëta konsumatori vazhdon të ketë edhe pas ndërrimit të njehsorit, pra pas periudhës kontestuese, ashtu që, me njehsorin e ri me nr. 88768888, shpenzimet janë si vijon: periudha **12/2023** është **535 kWh** dhe periudha **01/2024** është **590 kWh**.

Bordi e shqyrtoi edhe Procesverbalin e Inspektimit të KEDS të dt. 11.03.2024, në të cilin ndër të tjera është evidentuar se: *“Tek ky konsumator ora është në gjendje të rregullt dhe nuk ka nevojë të ndërrohet”*. Gjithsesi, DMK thekson se, konsumatorit i është ndërruar njehsori në janar të vitit 2023, ndërkaq, konsumatori nuk ka pasur ankesa në faturim pas ndërrimit të njehsorit, dhe se njehsori i ri, i vendosur në janar të vitit 2023 tek ky konsumator është në rregull dhe bën faturim të saktë, kjo nuk ka qenë kontestuese as nga konsumatori dhe rrjedhimisht, administrimi i kësaj prove nuk ka ndikim që të vendoset ndryshe lidhur me këtë rast.

Pra, Bordi i ka shqyrtuar faturat kontestuese të konsumatorit dhe duke e pasur parasysh shpenzimin e përgjithshëm të konsumatorit, konstaton se, faturimi i kWh për periudha 12/2022 dhe 01/2023 nuk mund të paraqet shpenzim real të konsumatorit. Andaj, DMK me të drejtë ka vendosur që, për periudhën e kontestuar t'i anulohet këto fatura, dhe se për këta muaj, konsumatori duhet të faturohet me shpenzimet e regjistruara të vitit të ardhshëm, me njehsorin elektrik me nr. 88768888 për muajt 12/2023 dhe 01/2024. Kjo për faktin se, Konsumatorit i është ndërruar njehsori elektrik 31.01.2023, pasi që i ka pranuar dy fatura të larta, ndërkaq nga KEDS/KESCO nuk është sqaruar se përse i është ndërruar njehsori Konsumatorit, dhe as nuk është dërguar Raporti i Shqyrtimit të Njehsorit nga QK.

Bazuar në të gjitha analizat e bëra, konstatohet se KESCO nuk ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifat tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme) dhe 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit univerzal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit. 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*.

Bordi i ZRrE-së duke u bazuar në të gjitha dëshmitë e prezantuara nga palët, si kërkesat/ankesat e konsumatorit, procesverbalet, Transaksionet, listat e leximit, rrjedhën e energjisë elektrike dhe



provave tjera materiale si në shkresat e lëndës dhe në dispozitat e Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s;
- Konsumatorit **I.A.**, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.